

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: /Znj. Mila Ballhysa	Adresa postare: L.3, Durrës Adresa elektronike: mila.ballhysa@gmail.com Nr. Tel: 063 83 86 571	Data: 05/02/2026 Nënshkrimi:
---	--	---

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

1. Kur është planifikuar të nisë aksioni për prishjet e banesave dhe bizneseve në zonën historike, që përfshihen në projektin TID Durrës?
2. Sa objekte (banesa, biznese, troje) do të preken konkretisht nga ky aksion? Do të jetë IKMT që do ta drejtojë aksionin?
3. Deri më tani, sa familje që kanë emrat në listat e shpronësimeve të miratuara nga qeveria shqiptare në kuadër të këtij projekti kanë marrë paratë?
4. Aksioni i prishjeve do të zhvillohet me faza apo do të përfshijë të gjitha objektet që përfshihen në listat e shpronësimeve të miratuara deri më tani?
5. Sa familjeve që preken nga projekti TID u është propozuar nga bashkia Durrës strehimi në banesa sociale? Strehimi parashikohet të realizohet pranë sitit të ri të pallateve në Spitalë apo në ndonjë godinë tjetër?
6. Në protestën e së enjtes banorët kërkuan takim me bashkinë, takim që u ishte rekomanduar edhe në shkresën që mban datën 26/01/2026, të cilën AADF ia ka dërguar edhe kryebashkiakes Emiriana Sako, edhe ministrit të kulturës Blendi Gonxhja. A parashikon bashkia Durrës së bashku me Ministrinë e Kulturës të zhvillojë një takim me banorët? Nëse po, kur mund të zhvillohet?

Të tjera të dhëna

Pergjigjet e pyetjeve qe ju dergova do t'i perdor per te realizuar nje kronike per median ku une punoj, DurrësLajm.

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Informacionin e kerkoj ne menyre elektronike, ne dokument Ëord apo PDF.

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____
-----------------------------	--------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejttoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

1. Pyetje : Kur është planifikuar të nisë aksioni për prishjet e banesave dhe bizneseve në zonën historike, që përfshihen në projektin TID Durrës?

Përgjigje : Pas takimit të zhvilluar me Kryeministrin e vendit, banorët dhe përfaqësues të Bashkisë Durrës, janë angazhuar në verifikimin e dokumentacionit ligjor të familjeve të cilat e posedojnë pronën, por nuk kanë kryer procedurat e regjistrimit të saj pranë ASHK-së. Gjithashtu në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse po rishikohen vlerat e trashëgimisë kulturore të disa objekteve të vecanta, që preken nga projekti TID. Nga verifikimi dokumentacionit administrativ rezulton se Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit pranë bashkisë Durrës ka procedur vetem me njoftimin për lirimin e banesave në mënyrë vullnetare. Bashkia e Durrësit nuk ka marrë një vendim për prishjen e banesave/objekteve që ndodhen në zonën e projektit TID.

Pyetje : Sa objekte (banesa, biznese, troje) do të preken konkretisht nga ky aksion? Do të jetë IKMT që do ta drejtojë aksionin?

Përgjigje: Lidhur me informacionet për objektet, që preken nga projekti TID, mund të konsultoheni me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës” si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”, me vlerë 315,524,013.82 lekë “.

2. Pyetje : Deri më tani, sa familje që kanë emrat në listat e shpronësimeve të miratuara nga qeveria shqiptare në kuadër të këtij projekti kanë marrë paratë?

Përgjigje : Bashkia Durrës nuk disponon informacion të plotë dhe përfundimtar mbi numrin e familjeve që kanë përfituar pagesën e shpronësimit, pasi administrimi i procesit të likuidimit të vlerave të shpronësimit dhe verifikimi përfundimtar i përfituesve është në kompetencë të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit (ASHSH). Për sa më sipër, duhet t'i drejtoheni Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit për informacion të detajuar mbi statusin e pagesave dhe trajtimin e dosjeve të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe VKM nr. 107, datë 01.03.2023 dhe VKM nr. 477, datë 31.07.2025.

3. Pyetje : Aksioni i prishjeve do të zhvillohet me faza apo do të përfshijë të gjitha objektet që përfshihen në listat e shpronësimeve të miratuara deri më tani?

Përgjigje : Në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme “ i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës” si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”, me vlerë 315,524,013.82 lekë “, të gjitha procedurat do të zhvillohen hap pas hapi sipas legjislacionit në fuqi.

4. Pyetje: Sa familjeve që preken nga projekti TID u është propozuar nga bashkia Durrës strehimi në banesa sociale? Strehimi parashikohet të realizohet pranë sitit të ri të pallateve në Spitalë apo në ndonjë godinë tjetër?

Përgjigje : Bashkia Durrës ka në vëmendjen e saj që të ndjekë procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për strehimin, për të siguruar familjet të cilat ndodhen në kushtet emergjente për strehim, duke qenë se banesat e tyre prishen për shkak të ndërtimeve të veprave për interes publik, dhe ka propozuar që deri në momentin e kompensimit financiar të shpronësimit, këto familje të subvencionohen si familje përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura përkohësisht të pastreha si pasojë e restaurimit dhe rikualifikimit urban të zonës perspektive TID. Gjithashtu në vijim të bashkëbisedimeve të përbashkëta, do të shikohet edhe mundësia e sistemimit të tyre në një banesë, gjithmonë në përputhje me kriteret ligjore për strehimin të parashikuara në Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar.

5. Pyetje : Në protestën e së enjtes banorët kërkuan takim me bashkinë, takim që u ishte rekomanduar edhe në shkresën që mban datën 26/01/2026, të cilën AADF ia ka dërguar edhe kryebashkiakes Emiriana Sako, edhe ministrit të kulturës Blendi Gonxhja. A parashikon

bashkia Durrës së bashku me Ministrinë e Kulturës të zhvillojë një takim me banorët? Nëse po, kur mund të zhvillohet?

Përgjigje : Duke iu referuar shqetësimeve të paraqitura nga banorët, më datë 14.02.2026 është zhvilluar një takim me Kryeministrin e Shqipërisë ku banorët kanë adresuar kërkesat dhe shqetësimet e tyre lidhur me procesin. Në vijim të këtij takimi, institucionet e përfshira kanë vijuar koordinimin ndërinstitucional për shqyrtimin e çështjeve të ngritura nga banorët, në veçanti sa i takon: vlerës së shpronësimit; trajtimit të strehimit; çështje që lidhen me problematikat e regjistrimit të banesave të tyre. Bashkia Durrës mbetet e angazhuar për trajtimin e këtyre çështjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.